




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ëëë.kk.rks-gov.net; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Ne bazë të dispozitave të nenit 40.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 të datës 20.02.2008 dhe të nenit 52.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr.12479 dt. 21.11.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 15.07.2011, miraton këtë:

V E N D I M

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR NDËRRIMIN E PRONËS KOMUNALE ME PRONËN SHOQËRORE QË ADMINISTROHET NGA AKM-JA NË BAZË TË VENDIMEVE PËR SHPALLJE TË INTERESIT PUBLIK

I

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit autorizon Kryetarin e Komunës që të bëjë ndërrimin e pronës komunale me pronën shoqërore që administrohet nga AKP-ja në bazë të vendimeve të Kuvendit të Komunës për shpallje të interesit publik për prona të caktuara që administrohen nga AKP-ja e që janë me interes për zhvillimin e Komunës.

II

Zbatimin e këtij vendimi e bënë kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për implementim të tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16/17921

Gjilan, më 15.07.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues